

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Vjollca Dërmaku, në lëndën penale kundër të pandehurit H. Anga Gj për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 320 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, P.II.nr.1342/2016, të datës 25.07.2016 të cilën e përfaqësonte Prokurori Shefik Memeti në shqyrtimin fillestarë dhe publik, më datën 15.08.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit H. A, i lindur më.., me vendbanim në Gjilan rr.'..' nr. banesa..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 363 paragrafi 1 pika 1.1 të KPPRK-s,

REFUZOHET AKUZA

Më datë 15.Shkurt 2016,në rrugën "S.." në G,pas vërtetimit të gjenjdes faktike ,nga punëtorët e autorizuar të .t.është konstatuar se,i pandehuri...., me qëllim që vetës ti sjellë pasuri të kundërligjshme, ka bërë vjedhjen e energjisë elektrike ashtu që daljen e fazes së tretë "...” e ka futur në hyrje të fazes së tretë dhe në këtë mënyrë ka bërë hargjimin e paautorizuar të energjisë elektrike me çka ke pamundësuar regjistrimin e shpenzuar të energjisë elektrike duke e dëmtuar....në vlerë prej 38.91 euro.

- Me çka kishite kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 320 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë, P.II.nr1342/2016, të datës 25.07.2016 kundër të akuzuarit...., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 320 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datën 15.08.2017, Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, Shefik Memeti, ka heqë dorë nga ndjekja penale ndaj të pandehuritme arsyetim se i akuzuari pë të njejtën vepër penale është akuzuar dy herë, edhe atë me aktakuzën PP.II.nr. 1228/16 dhe 1432/16, e cila gjë vertetohet në bazë të shkresave të cilat gjinden në lëndë.

Andaj, meqenëse Prokurori është tërhequr nga aktakuza dhe ndjekja penale ndaj të akuzuarit ..., gjykata ka konstatuar se duke u bazuar në nenin 363 paragrafi 1 pika 1.1 të KPPRK, duhet të refuzuar akuzën e PTH në Gjilan, P.II.nr.1342/2016, të datës 25.07.2016, ndaj të akuzuarit...., për shkak të veprës së lartcekur penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 paragrafi 1-3 të KPP. kurse vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenit 454 paragrafi 1 të KPP-s

Për arsyet e lartcekura u vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 919/2016, Më 15.08.2017**

**Sekretarja juridike,
Vjollca Dërmaku dv.**

**Gjyqtari
Behar Ymeri dv.**

KËSHILLA JURIDIKE: Ky aktgjykim është i plotëfuqishëm ditën e shpalljes së aktgjykimit pasi që Prokurori I shtetit dhe pala e dëmtuar janë tërhequr nga ndjekja penale.